



AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË KRYESIA

Program i veprimtarisë së Akademisë së Shkencave për vitin 2020

Viti 2020 është viti *i parë i zbatimit të plotë të reformës* së ndërmarrë nga ASH në bashkëpunim me institucionet shtetërore, e cila mundësoi hedhjen e bazave ligjore të saj. Gjatë këtij viti do të vazhdojë realizimi i funksioneve dhe përparësive që krijon hapësira e re juridike e vetëveprimit dhe që kërkohen nga ligji për plotësimin e misionit institucional të ASH, siç janë:

- a). *Përtëritja e anëtarësisë së Asamblesë së ASH* me kandidatë të rinj, nga radhët e kërkuesve dhe studiuesve më të suksesshëm brenda e jashtë vendit (pika 4/1 të ligjit);
- b). *Riorganizimi i plotë i strukturave pranë saj* dhe vënia e tyre në eficiencë; hapja e ASH ndaj institucioneve të arsimit të lartë dhe qendrave të kërkimit në vend, rritja e bashkëpunimit me to (pika 4/3);
- c). *Rikthimi i rolit aktiv të ASH* në fushat kryesore të kërkimit shkencor (pika 4/2);
- ç). *Përbushja e rolit pararendës* në përcaktimin e nevojave kryesore të kërkimit në fushat e së ardhmes, sot për sot të fragmentuar e në nivel jo të kënaqshëm (pikat 4/5-6);
- d). *Vendosja e ASH* në *rolin koordinues* në zhvillimin e shkencave aplikative me *impakt kombëtar* (pika 4/15);
- dh). *Konsolidimi i rolit parësor e strategjik* të ASH në zhvillimin e rritjen cilësore të shkencave albanologjike (pika 4/17);
- e). *Ushtimi i rolit* të ASH *në funksionin e garantit* të *mbrojtjes* dhe *pasurimit* të *shqipes* së njësuar (pika 4/3-8);
- ë). *Forcimi cilësor* i ASH si ent botues i veprave madhore, veprave të zgjedhura dhe antologjive, në ndihmë të transmetimit të dijes në shkolla (pikat 4/8-12);

- f). Rritja e veprimtarisë së ASH si promovuese dhe vlerësuese e arritjeve e botimeve më të mira në fushat e shkencës e të kulturës nëpërmjet dhënies së çmimeve (pika 4/13);
- g). Aktivizimi si organizatore dhe bashkorganizatore kryesore të veprimtarive shkencore kushtuar përvjetorëve të ngjarjeve të mëdha historike, si dhe të atyre të organizuara në fushat kryesore të shkencës dhe dijes (pika 4/11);
- gj). Institucionalizimi i ndërveprimit e bashkëpunimit afatgjatë me ASHAK, me përfaqësues të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë së Veriut (më tej: MANU) dhe të qendrave kryesore kërkimore me interes për botën shqiptare, veçanërisht në fushën e albanologjisë (pika 4/16);
- h). Rritja e kapaciteteve të saj dhe e koordinimit me institucionet e tjera për térheqjen e projekteve (pika 4/10);
- i). Garantimi i një pjesëmarrjeje aktive e me përgjegjësi në institucionet ndërkombëtare, si ALE, AIESEE, UNESCO, UAI etj.; forcimi i bashkëpunimit me akademitë simotra, veçanërisht ato të rajonit e me ALLEA (pika 4/10);

I. Pranimet e reja. Një nga qëllimet kryesore të reformës është garantimi në vazhdimësi i rifreskimit të Asamblesë, duke pranuar në radhët e saj ndër kërkuesit e studiuesit më të suksesshëm të gjeneratave në vazhdim, nëpërmjet kritereve të qarta e të matshme krahasimisht për çdo fushë. Ligji e statuti i ri *lejojnë të vendoset një raport i drejtë midis gjeneratave, duke shmangur përfundimisht çdo lloj diskriminimi moshor midis anëtarëve*, kriter i cili nuk ka lidhje as me meritën, as me cilësinë. Kjo në të njëjtën kohë mundëson *hapjen e vendeve të reja* pa improvizuar kurrfarë diskriminimi. Dhënia e statusit akademik emeritus për anëtarët e Asamblesë mbi 75-vjeç nuk është vetëm një vlerësim i karrierës së tyre mbi 50-vjeçare në kërkim e mësimdhënie, por edhe një mënyrë se si Asambleja të hapë në vazhdimësi rrugën për freskimin e saj me anëtarë të rinj. Procedurat e kriteret e vendosura në statut e në ligj realizojnë kërkeshat kryesore të shprehura e kërkua e nga mjediset e gjera intelektuale ndaj ASH: që *pranimet të mbështeten mbi botime e kontribute të indeksuara ndërkombëtarisht* e ato të kryhen përmes një procesi transparent. Statuti i ri synon që referimet në to të mos bëhen mekanikisht, por plotësimi i tyre mbetet thelbi i vlerësimit të çdo kandidati. Përfshirja me statut i strukturave të institucioneve të arsimit të lartë dhe i qendrave të kërkimit në vlerësimin e kandidaturave plotëson kërkeshën që procesi të jetë sa më transparent, duke garantuar atë që titullin akademik çdo individ që konkuron ta fitojë në sajë të punës e aktivitetit të tij 30-40-vjeçar, iniciuar pikërisht atje ku ka zhvilluar e zhvillon aktivitetin e tij mësimor-shkencor, ndërsa në thelb Asamblesë i mbetet thjesht të konfirmojë këtë realitet me votën e saj në bazë të ligjit.

Rritja e cilësisë së anëtarësisë, në përputhje me mundësitë e shtysat e reja, që nxisin mjedisin shkencor ndërkombe të kërkuesit progresive të kohës, janë mesazhi kryesor që duhet e do të përcjellë Asambleja ndaj bashkësisë shkencore në vend. Vetëm kështu ASH mund të luajë rol parësor kundër fiktivitetit, plagiaturës e falsifikimeve në marrjen dhe mbrojtjen e doktoraturave e më tej. Ne ndërmorëm një vit më parë iniciativën për të luftuar këto fenomene me ligj, por, pavarësisht nga përkrahja e opinioneve shkencore, kjo iniciativë ka mbetur ende e bllokuar. Megjithatë, ASH kodin europian për etikën në kërkimin shkencor e ka bërë pjesë të Statutit të saj.

II. Ristrukturimi i Asamblesë, i strukturave pranë saj dhe i Akademisë së të Rinjve.

Riorganizimi i Akademisë së të Rinjve në bazë të ligjit e statutit është një sfidë e re që duhet të realizohet në vitin 2020. Ne sapo kemi ngritur komisionet sipas fushave a fushave të përaferta, një praktikë e re përfshirë fuqizimin e veprimtarisë së Asamblesë. Përfshirja në to e shumë specialistëve, nga radhët e kërkuesve dhe studiuesve më cilësorë, do të mundësojë zhvillimin e një debati më profesional përfshirë çdo fushë, evidentimin më konkret të nevojave e problemeve në kërkim a transmetim të dijes në fushën përkatëse, rritjen e rolit të çdo akademiku përfshirë propozuar e drejtuar zhvillimin a ndërmarrjen e aktiviteteve, studimeve apo iniciativave të caktuara.

I rëndësishëm është fakti i pranimit në komisione të një numri përfaqësuesish nga institucionet e tjera të arsimit të lartë a të kërkimit shkencor po aq sa anëtarët e Asamblesë, çka një hapje konkrete e ASH ndaj komunitetit shkencor në tërësi. Duhet theksuar se gjatë vitit 2020 e më tej komisionet do të jenë propozuesit dhe protagonistët kryesorë të ideve e ndërmarrjeve të ASH, vërtet si hallkë këshillimore, por, si seksionet, ashtu dhe Kryesia e Asambleja, do të mirëpresin çdo propozim të tyre dhe vendimmarrjet do të bëhen mbështetur në këto propozime, duke përzgjedhur në bazë të rëndësisë dhe mundësive të realizimit.

Po në drejtim të hapjes së ASH, deri në fund të vitit 2020 do të bëhet plotësimi i Asamblesë nëpërmjet pranimeve të reja si anëtarë të saj dhe si anëtarë të jashtëm, zgjedhur prej individëve më të suksesshëm me origjinë shqiptare e aktivitetet jashtë vendit. Ndërkojë çdo komision do të krijojë gjithashtu rrjetin e bashkëpunëtorëve për çdo fushë, duke evidentuar e ftuar për bashkëpunim ndër më të spikaturit në fushën përkatëse jashtë vendit. Jemi të ndërgjegjshëm se angazhimi i tyre nuk varet vetëm nga vullneti ynë. Por kemi bindjen se studiuesit që do të marrin një ftesë bashkëpunimi vlerësues nga ASH do të japid kontribut shkencor, qoftë dhe vetëm konsultativ.

III. Ngritja e njësive të reja të kërkimit

ASH, ndër misionet kryesore të saj, ka promovimin e kërkimit në fushat e reja apo në ato më jashtë vëmendjes në raport me kohën. Gjatë vitit 2020 ASH do ta ndërmarrë posaçërisht këtë rol për tri fusha kryesore të shkencës e dijes. Tashmë të gjithë janë të ndërgjegjshëm e të mrekulluar për zhvillimin, arritjet e perspektivat që kanë shkencat bashkëkohore si *nanoshkenca* e *nanoteknologjia*, *bioshkenca*, *biomjekësia*, *gjenetika*, *teknologjitet e informacionit*, *inteligjenca artificiale*. Këto janë shkencat që zhvillohen më me vrull dhe që tek ne janë ende pak të zhvilluara e me një kërkim fragmentar. Për këtë arsy, duke filluar nga 1 janari, pranë ASH do të ngrihen tri njësi kërkimore studimi me një afat 1-2 vjeçar, mundësi kjo që e jep reforma e re. Ky hap i jep ASH një rol aktiv në kërkimin shkencor. Në përbërje të tyre janë zgjedhur e do të zgjidhen njerëz, me përvojë e të suksesshëm në fushat përkatëse.

- a). Njësia e *nanoteknologjisë* do të drejtohet prej akad. Arben Merkoçi.
- b). Njësia e *bioteknologjisë e gjenetikës* do të drejtohet nga prof. Ilia Mikerezi, në bashkëpunim me akad. Efigjeni Kongjika.
- c). Ndërsa *njësia e inteligjencës artificiale* do të drejtohet prej akademik Neki Frashërit, në bashkëpunim me prof. Mira Mezini, një prej kërkueseve më të suksesshme të kësaj fushe të re të dijeve njerëzore.

Qëllimi i njësive të reja të kërkim-studimit është luajtja fillimisht e një roli koordinues dhe evidentues për gjendjen e kërkimit në vend në këto fusha për të propozuar më tej *hapat që duhen ndërmarrë për të krijuar qendra elitare* të kërkimit në çdonjérën prej tri disiplinave të përmendura. Përvoja e nxjerrë prej themelimit të tyre do të tregojë efektivitetin e ngritjes së qendrave kryesore elitare pranë ASH si qendra koordinimi të kërkimit me institucionet e tjera, çka mund të bëhet nëpërmjet drejtimit shkencor të njësive prej një bordi të përfaqësuar nga ASH, institucionet kërkimore-universitare përkatëse apo qendrat spitalore. Ato do të shërbejnë si model i efikasitetit të vendosjes së ASH në rolin e koordinatorit të kërkimit në fushat kryesore.

IV. Nxitja, promovimi dhe koordinimi i studimeve në fushën e albanologjisë

ASH e ka kryer me sukses deri 10 vjet më parë këtë rol në mënyrë aktive e të suksesshme, pasi pranë saj ishin edhe institutet përkatëse të vendit. Është i mirënjohur fakti se reforma e vitit 2007 dhe vetë tranzicioni i vështirë e i tejzgjatur, shoqëruar me probleme të imprehta në tërë rrjetin e arsimit të lartë, kanë bërë që *paradigma themelore e kërkimeve në albanologji* të tronditet dhe interesit e mbështetja për të me fonde, specialistë e mjete të minimizohet.

Për këtë arsy, vlerësohet që ndër aktivitetet kryesore për vitin 2020 të jetë *zhvillimi i një konferencë mbarëshqiptare në fushat e albanologjisë*, në të cilën, krahas paraqitjes së studimeve apo referimeve kryesore në çdo fushë, të

konkluzioneve dhe tezave kryesore për gjuhën shqipe dhe origjinën e saj, për identitetin e shqiptarëve, për ngjarjet e epokat kryesore, të përcaktohet dhe strategjia e kërkim-studimit në këto fusha, mënyra e koordinimit të punës midis ASH dhe ASHAK, si dhe me ASA e institucionet e tjera akademike-universitare në gjithë hapësirën historike shqiptare, përfshirë dhe qendrat kryesore të albanologjisë së sotme në botë.

Një rol të rëndësishëm këtu do të luajë edhe ringritja e vënia në funksion e Këshillit Ndërakademik Kombëtar të Gjuhës Shqipe. Ky institucion vlerësohet që të punojë në bazë të një rregulloreje të mirëpërcaktuar, të ketë në përbërje përfaqësues të ASH, ASHAK, nga radhët e gjuhëtarëve shqiptarë në Maqedoninë e Veriut, në Mal të Zi dhe prej arbëreshëve. Synimi ynë mbetet i pandryshueshëm: hartimi dhe miratimi i një ligji për mbrojtjen e gjuhës shqipe, mbështetur me akte nënligjore për respektimin e gjuhës së njësuar në të gjitha funksionet e saj publike. Mbrojtja, përpunimi e zhvillimi i gjuhës standarde do të mbështetet me ndërmarrjen e botimit të *fjalorit të ri të shqipes*, si dhe me *numerizimin e fjalorit aktual*.

V. Veprimitaria botuese

ASH do të forcojë misionin e saj si një ent botues i veprave madhore i veprave zgjedhura të akademikëve apo figurave më të rëndësishme të shkencës, dijes e kulturës shqiptare. Krahas botimit të *fjalorit të shqipes* do të fillojë puna për hartimin dhe konceptimin, përgatitjen dhe botimin e Enciklopedisë Shqiptare, të Historisë së popullit shqiptar, të akteve të Këshillit Ndërakademik të Gjuhës Shqipe. Ndër botimet kryesore të këtij viti do të jetë seria e plotë e Studimeve etimologjike për gjuhën shqipe, vepër jetësore e dekanit të albanologjisë akad. Eqrem Çabejt, që është bërë e njohur për studiuesit në mënyrë të fragmentuar nisur prej vitit 1971 deri më sot. Gjatë këtij viti do të botohet për herë të parë vepra e plotë dyvëllimshme e Thimi Mitkos, një prej prekursorëve të Rilindjes Kombëtare, nyje lidhëse midis shqiptarëve, arbëreshëve dhe arvanitëve, në 200-vjetorin e lindjes; një vëllim me studime-kontributë të posaçme kushtuar besimeve të shqiptarëve dhe bashkëjetesës së tyre do t'i përgjigjet prioritetit të Shqipërisë në vitin e kryesimit të OSBE-së; si dhe aktet e konferencës shkencore kushtuar 75-vjetorit të Çlirimit, që rikonfirmojnë rëndësinë historike të rreshtimit të popullit shqiptar në aleancën e fitimtarëve.

Në fushën e botimeve do të punohet për të ndërmarrë e përgatitur botime të karakterit përbledhës e bibliografik për çështjet kryesore të origjinës së gjuhës shqipe dhe të popullit shqiptar; për sqarimin e problemeve ende të diskutueshme lidhur me periudhat kryesore historike të kombit; për përzgjedhjen dhe botimin e materialeve ndihmëse për shkollat, në formën e

antologjive të mendimit, të krestomactive shkencore, sidomos në fushat e gjuhësisë dhe të historisë, si dhe nxitja e pjesëmarrjes së akademikëve në hartimin e teksteve shkollore, sidomos tvë atyre universitare.

Për rritjen e cilësisë së botimeve do të jetë e detyrueshme të bëhen një sërë përmirësimesh, duke filluar nga vendosja e disa kritereve më të qarta për këshillin e botimeve, ku t'u jepet përparësi në botim veprave madhore, veprave të zgjedhura dhe atyre përbledhëse e bibliografike; për të vijuar me përcaktimin e kritereve për vlerësimin e botimeve në bazë të rëndësisë së studimit, gjinisë, llojit, deri tek *ngritja e një nënkomision i akademik për të bërë vlerësimet, rikompozimi i këshillit të botimeve me përfaqësim më të gjërë*, si dhe rritja e botimeve në gjuhën angleze apo përbledhjeve të tyre kur kjo është e mjaftueshme.

Interesi ynë e do që botimet madhore sidomos në fushën e albanologjisë të jenë të lexueshme për mjedisin ndërkombëtar albanologjik. Gjatë vitit 2020 do të botohen anglisht dy vepra monografike me interes për studiuesit e huaj: *Skënderbeu,jeta dhe vepra*, nga akad. Kristo Frashëri dhe *Atlasi i qyteteve dhe i kështjellave ilire* nga akad. Apollon Baçe.

Për të njëjtat motive, duke filluar nga ky vit, edhe *Studia Albanica*, ashtu si JNTS, do të dalë në gjuhën angleze. Rritja e cilësisë së tyre në përbajtje, si dhe rritja e lexueshmërisë së tyre *nëpërmjet publikimit online*, janë dy sfida për t'u realizuar, në mënyrë që në një kohë sa më të shpejtë këto botime të përfshihen në listën e revistave me rankim cilësor ndërkombëtar. Për këtë do të synohet që, përveç redaksive të botimeve, pranë tyre të ketë edhe një bord shkencor nga kërkuesit ndër më të suksesshmit shqiptarë dhe të huaj. Do të fillojë menjëherë numerizimi i revistës *Studia Albanica* prej numrit të parë, gjë që do të bëjë të mundur këshillimin e saj *online* dhe riintegrimin shkencor.

VI. Roli i bibliotekës shkencore të ASH si lider rajonal i katalogimit të librit shkencor

Biblioteka shkencore e ASH do të vijojë punën për numerizimin dhe publikimin online të bibliografive të anëtarëve të Asamblesë, që do të vazhdojë edhe me bibliografitë personale të bashkëpunëtorëve të saj. Biblioteka shkencore e ASH është tashmë faktor rajonal përfshirjen e rrjetit të bibliotekave shkencore dhe publike në programin “Cobiss”, që luan sot një rol të pazëvendësueshëm në ndërkomunikimin shkencor në Ballkan dhe në Europën Qendrore. Biblioteka e ASH ka sot një rol lideri jo vetëm për pranimin e programit Cobiss të katalogimit të njësuar të librit shkencor, por edhe për krijimin e një consortium-i të bibliotekave shqiptare të anëtarësuara dhe të abonuara në këtë sistem, që vlerësohet nga më të avancuarit për shkallën e hapjes ndaj lexuesit shkencor. Këtij misioni do t'i shërbejë edhe marrëveshja e bashkëpunimit me ATSH.

Biblioteka shkencore e ASH gjatë vitit 2019 i ka shërbyer politikës së një ndërveprimit të suksesshëm institucional me rrjetin e universitete të vendit, duke dhuruar koleksionet e botimeve tona në Universitetin e Tiranës, të Kamzës, të Gjirokastrës, të Vlorës, si dhe në Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës në Maqedoninë e Veriut. Kjo nismë do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2020. Në marrëveshje me Ministrinë e Diasporës, koleksionet e botimeve akademike do të dhurohen e dhe në departamente të albanologjisë jashtë kufijve shtetërorë.

VII. Oponenca dhe rekomandime për Qeverinë

Një nga misionet kryesore të ASH është të ofrojë oponenca e rekomandime ndaj Qeverisë për fusha të caktuara, me rëndësi e efekt të veçantë. Pikërisht për këtë pranë ASH është *ngritur njësia e kërkim-studimit që drejtohet nga prof. Shyqyri Aliaj*, me qëllim përcaktimin e masave që duhen marrë për aktet rregulluese të pranimit të kodeve europiane në ndërtim, me synim garantimin e tyre nga ana sizmike. Si hap i parë i kësaj njësie është kthimi në detyrues për projektet e ndërtimeve të reja të rregullave të sintetizuara dhe të rekomanduara prej studimeve më të fundit të kryera tek ne. Një masë e tillë do të ishte një hap mjaft pozitiv në respektimin e standardeve europiane në fushën e ndërtimit. Ne i kemi kërkuar Qeverisë që kjo njësi të vijë duke u zgjeruar dhe ajo të luajë *rolin e koordinuesit dhe oponentit kryesor*, deri në futjen e plotë të eurokodeve në ndërtim për mbrojtjen sizmike të ndërtesave nga tërmetet. Nga veprimtaria e konkluzionet e kësaj njësie do të dalin në pah problemet që ka kërkim-studimi në fushën e gjeofizikës e sizmologjisë, niveli i kërkimit në to, mbështetja financiare e logjistike për to, çka do të jenë një bazë e plotë për t'i rekomanduar Qeverisë masat që duhen marrë duke filluar nga ato organizative-strukturore për të vendosur institucionet përkatëse në nivelin që kërkon nevoja tek ne si një territor me risk tektonik të ndjeshëm.

Plotësimi i tyre do të çojë në korrigjin e gabimit historik të bërë më 2007, duke i shkëputur edhe institucionet me impakt kombëtar prej ASH, çka solli për pasojë prishjen e një sistemi funksional të strukturave kërkimore. Kjo përvojë, së bashku me atë të njësive të kërkim studimit në fushat e nanoteknologjisë dhe shkenca të tjera të reja, do të na shërbejë për të rikonceptuar riorganizimin strukturor të ASH, në bazë të hapësirave që krijoi ligji i ri, duke i dhënë përgjigje përfundimtare dilemës a debatit për një akademi me apo pa institute.

VIII. Veprimtaritë kryesore shkencore të vitit

Akademia në vazhdimësi është përpjekur për të kryer një nga misionet e saj kryesore të organizimit të konferencave, kongreseve, për ngjarjet më madhore të vitit, si dhe të konferencave e kongreseve apo seminareve në fushat kryesore të dijes. Këtë mision ajo do ta kryejë edhe gjatë vitit 2020, gjatë të cilës ASH do të jetë bashkorganizatore për aktivitete të tilla, si: *konferenca dhe botimet kushtuar 100-vjetorit të parlamentarizmit; konferenca për 200-vjetorin e Thimi Mitkos; kongresi i 50-të ndërkombe tar i studiuesve të baladave; konferenca ndërkombe tar e albanologjisë* (e shoqëruar me një panair të botimeve akademike); *konferenca ndërakademike për studimet albanistike në arealin e frëngjishtes; konferenca ndërakademike për poezinë shqipe në shekullin XXI.* Krahas tyre një rëndësi të veçantë ka konferenca rajonale me qendrat sismologe të rajonit, që mendohet të zhvillohet në periudhën shkurt-mars të 2020, me qëllim marrjen e një përvoje më të gjerë e rritjen e bashkëpunimit për të përcaktuar masat që duhen marrë në konsolidimin e kërkimeve e studimeve *në fushën e sismologjisë* dhe të *ndërtimeve rezistente.* Gjatë vitit 2020 do të zhvillohen konferenca përkatëse shkencore duke filluar nga ajo për *nanoteknologjinë parashikuar tashmë* për në tector dhe në fusha të tjera kryesore.

IX. Tërheqja e projekteve

Venia në funksionim e komisioneve, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të tjere të spikatur të institucioneve të arsimit të lartë dhe ato kërkimore, *ngritja e katër njësive të reja pranë ASH* me përbërje të zgjedhur ndër shkencëtarët e kërkuesit më në zë të fushave përkatëse dhe drejtimi prej tyre; zhvillimi i konferencave kombëtare pranë strukturave tona, me bashkëpunimin e shkencëtarëve e kërkuesve më të suksesshëm jashtë vendit; *ngritja e njësisë së projekteve e monitorimit* si pjesë e administratës së ASH; do të forcojnë ndjeshëm kapacitetin e ASH për projekte të përbashkëta në bashkëpunim me institucione brenda e jashtë vendit. Kjo përbën një nga sfidat kryesore tonat për 2020 e në vazhdim.

X. Bashkëpunimi me ASHAK

Vendosja mbi baza të reja të bashkëpunimit të ASH me ASHAK është një nga priorititetet kryesore të vitit 2020. *Ringritja e Këshillit Ndërakademik Kombëtar* për *Gjuhën Shqipe* dhe venia në funksionim e tij, nisja e punës për hartimin e konceptit paraprak të *Enciklopedisë Shqiptare*, hartimi i *Historisë së popullit shqiptar* dhe i një *fjalori të ri të shqipes*, krahas me përballimin e detyrave të shkencës albanologjike për plotësimin e të dhënave të gjuhës sonë në *Atlasin Gjuhësor European*; si dhe organizimi i një konference mbarëshqiptare për albanologjinë, janë disa nga priorititetet e këtij bashkëpunimi. Për të mbështetur sa më sipër e për ta shtrirë këtë bashkëpunim në gjithë fushat do të rinovohet protokolli dyvjeçar i bashkëpunimit.

Zbatimi gradual i hapjes që jep ligji i ri për pranimin e anëtarëve të jashtëm nga radhët e anëtarëve të akademive simotra në ALLEA është një mundësi reale për të koordinuar bashkëpunimin para së gjithash midis ASH dhe ASHAK. Krahas kësaj, gjatë vitit 2020 do të nisë dhe realizimi i detyrimeve që vijnë nga marrëveshja e pranuar me MANU, me Agjencinë e Zbatimit të Shqipes në Maqedoninë e Veriut, me Këshillin e Trashëgimisë Kulturore të Kosovës. Ky bashkëpunim ka si qëllim kryesor koordinimin e aktorëve dhe të gjithë kapacitetave shqiptare në funksion të kultivimit e mbrojtjes së gjuhës së njësuar shqipe dhe të thellimit të studimeve në fushën e albanologjisë.

XI. Marrëdhëniet me ALLEA, organizatat shkencore ndërkombëtare dhe marrëdhëniet ndërakademike

Gjatë vitit 2019 u bë e mundur që ASH të rifitojë statusin e anëtarit me të drejta të plota në Unionin Akademik Ndërkombëtar (UAI). Në vijim do të stabilizohen përfundimisht komitetet shkencore kombëtare që funksionojnë sipas standardeve ndërkombëtare pranë akademive të shkencave. Është e ditur se ka pasur probleme dhe mungesa si në funksionimin e komitetit shkencor kombëtar të AIESEE-së, gjë që ka krijuar mospërfaqësim edhe në hartimin e tekstit të Historisë së Ballkanit; ashtu edhe në funksionimin e komitetit shkencor kombëtar të Atlasit Linguistik European (ALE). Me shpejtësi do të korrigohen deficitet e krijuara, duke riaktivizuar pjesëmarrjen e ASH në to dhe duke zgjedhur specialistët e duhur për të na përfaqësuar aktivisht bashkëpunimin me këto institucione. Në komitetet shkencore kombëtare që ngrihen pranë ASH, në rastet kur ASHAK nuk ka një të tillë, do të ftohen të marrin pjesë edhe ekspertë të rekanduar prej saj.

Nënshkrimi i afërm i marrëveshjes dhe protokollit me MANU, pranuar në parim nga të dyja palët, do të krijojë mundësi që ASH të jetë më e pranishme dhe më me fuqi ndikimi edhe në institucionet universitare shqiptare në Maqedoninë e Veriut. Bashkëpunimi ndërakademik do të plotësohet me një mundësitet e shumta që ofrohen prej bashkëpunimit me universitetet jashtë vendit, ku albanologjia ka statusin e një njësie mësimdhënëse. Projekti i propozuar nga akad. Francesco Altimari për përfshirjen e ASH në nismën shkencore europiane për hartimin e një fjalori terminologjik të teknologjisë së tekstileve prej pëlhure; projekti tjetër i drejtar prej tij dhe akad. Matteo Mandalà për kërkime të ndërsjellta shkencore gjegjësisht tek arvanitët dhe tek greqishtfolësit e Italisë së Jugut, me mbështetjen e ASH, do të nisin së zbatuari gjatë vitit 2020. Normalizimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit me akademi të shkencave të rajonit është një përparësi tjetër, që i shërben jo vetëm krijimit të sinergjive akademike, por edhe diplomacisë shkencore. Gjatë vitit të ardhshëm do të synohet përgatitja dhe nënshkrimi i marrëveshjeve edhe

me akademi me të cilat kemi pasur traditë bashkëpunimi të suksesshëm, por, për shkaqe e rrethana historike, kjo traditë është ndërprerë¹.

Akad. Skënder Gjinushi


Kryetar

Tiranë, 19. 12. 2019

¹ Lista e plotë dhe aktiviteteve dhe botimeve të ASH do të paraqitet në fund të janarit, për të mundësuar një konsultim me komisionet e sapongritura pranë saj.